

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

GALANTERI

Niveli III i KSHK
(1 vjeçar)

(Në drejtimin mësimor Tekstil-konfeksione)

Kodi: D4-III-20

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2020

- I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), të drejtimit mësimor “Tekstil-Konfeksione”.**
- II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK.**
1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Galanteri”, niveli II
 2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK
 3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK
 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK
- III. Plani mësimor për profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK.**
- IV. Udhëzime për planin mësimor**
- V. Udhëzime për procesin mësimor.**
- VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**
- VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK,**
- VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**
- IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**
- X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me sektorin e galanterisë dhe gëzofit”*. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Galanteri” niveli III i KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Tekstil-Konfeksione”, niveli II i KSHK;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Galanteri”, niveli III i KSHK, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:



- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3.Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Galanteri”, niveli III i KSHK

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Galanteri”, niveli III i KSHK, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin e II të KSHK, si dhe të ushtrojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të përcaktojë vetitë e lëkurave të gatshme sipas përdorimit të tyre;
- Të përzgjedhë lëkurat që përdoren për veshje;
- Të përzgjedhë ngjitesat sipas llojit të lëkurës;
- Të përcaktojë llojet e penjëve për galanteri;
- Të përshkruajë llojet e tegelave që përdoren për qepje sipas vetive të lëkurëve;
- Të analizojë ndikimin e vetive të lëkurëve të ndryshme në klasifikimin e mjeteve dhe makinerive qepëse;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e makinave familjare dhe industriale për qepjen e veshjeve prej lëkure;
- Të realizojë skica teknike të veshjeve dhe aksesorëve prej lëkure;
- Të përzgjedhë lëkurën në varësi të modelit në skicë;
- Të përzgjedhë llojet e astarëve që përdoren në galanteri;
- Të përshkruajë vetitë e masave plastike dhe të gomës në galanteri;
- Të ndërtojë kallëpet me shenjat përkatëse të referimit për veshje dhe aksesorëve prej lëkure;
- Të zgjedhë lëkurën, penjtë dhe aksesorët e përshtatshëm për modelin përkatës të veshjeve të ndryshme;
- Të qepë dhe montojë elementë të ndryshëm veshje me material lëkure;
- Të qepë dhe realizojë veshje këmbë të thjeshta (pupa, papuçe etj.);
- Të qepë dhe realizojë aksesorë të ndryshëm prej lëkure (rripa të llojeve të ndryshëm, kuleta, doreza etj.);



- Të përzgjedhë aksesoret e nevojshëm funksionalë dhe dekorativë (fije, zinxhirë, shirita etj.);
- Të logarisë koston e modelit kampion;
- Të kontrollojë kryerjen e punimeve;
- Të respektojë standartet e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit të punës;
- Të përdorë në mënyrë të pavarur literaturat profesionale.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Galanteri”, niveli III i KSHK.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si punëtor i kualifikuar në sektorin e galanterisë. Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin IV (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Galanteri”, niveli III i KSHK

Plani mësimor për profilin mësimor “Galanteri”, niv. III i KSHK			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/ Vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-20	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-10-433-16	Njohuri për lëkurën	2
3	L-01-434-16	Mjetet dhe makineritë për prerjen dhe qepjen e lëkurës	1
4	L-10-435-16	Teknika të realizimit të veshjeve dhe aksesoreve prej lëkure	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-10-1317-16	Konfeksionimi i fundit prej lëkure	69



2	M-10-1318-16	Konfeksionimi i xhaketës prej lëkure	85
3	M-10-1319-16	Konfeksionimi i dorezave prej lëkure	33
4	M-10-1320-16	Konfeksionimi i çantës prej lëkure	51
5	M-10-1321-16	Konfeksionimi i rripave prej lëkure	34
6	M-10-1322-16	Përgatitja dhe realizimi i pupave prej lëkure	85
7	M-10-1323-16	Konfeksionimi i kapeleve prej lëkure	51
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-10-1324-16	Realizimi i aksesorëve të ndryshëm prej lëkure	51
2	M-10-1325-16	Realizimi i veshjeve dhe aksesorëve me lëkure dhe materiale alternative	51
3	M-10-1326-16	Realizimi i objekteve tridimensionale me material lëkure dhe gëzofi	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/ 1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Galanteri”, niveli III i KSHK, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që *planifikimi i mësimdhënies* të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara



dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përmbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Galanteri”, niveli III i KSHK.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Galanteri”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushtet për zbatim.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Galanteri”, niveli III i KSHK, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e rrobaqepsisë, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit III të KSHK.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Galanteri”, niveli III i KSHK

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Galanteri”, niveli III i KSHK, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me



Certifikatën e aftësimi profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
 - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
 - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit III i KSHK.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-20). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- të përshkruajnë kuptimin, rëndësinë dhe rolin e sipërmarrjes në kontekstin individual dhe shoqëror
- të përshkruajnë veçoritë e sjelljes sipërmarrëse të individëve
- të analizojnë aftësitë dhe mundësitë personale në kontekstin e nismave sipërmarrëse
- të bëjnë vlerësimin e kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive të tyre për karrierën e ardhëshme
- të zbatojnë procedurat për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve të duhura në lidhje me to.
- të mbajnë qëndrim kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve të mundshme
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e etikës së komunikimit dhe negocimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të përshkruajnë dhe zbatojnë parimet e punës individuale dhe të punës në grup
- të analizojnë veçoritë e gatishmërisë, iniciativës dhe motivimit në kontekste të ndryshme jetësore
- të tregojnë përgjegjësi individuale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme jetësore
- të planifikojnë, sigurojnë dhe përdorin me efikasitet burimet e ndryshme si mjedisin, burimet njerëzore, paratë, kohën etj.
- të përshkruajnë veçoritë dhe kërkesat për udhëheqjen e sipërmarrjeve të ndryshme
- të përshkruajnë veçoritë dhe impaktin e globalizimit, informacionit, mjedisit dixhital dhe mediave sociale në shoqërinë e sotme dhe të së ardhmes
- të përshkruajnë veçoritë e sipërmarrjes së biznesit dhe të sipërmarrjes sociale
- të përshkruajnë format e ndryshme të organizimit të sipërmarrjeve dhe karakteristikat e tyre
- të analizojnë faktorët që ndikojnë në veprimtarinë e sipërmarrjeve, të tillë si tregjet, klientela, konkurrenca, kostot etj.
- të përshkruajnë mjedisin ligjor dhe fiskal të sipërmarrjeve
- të përshkruajnë mërrëdhëniet e punës në një sipërmarrje.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Kuptimi, rëndësia dhe roli i sipërmarrjes	3 orë
Tema 2	Aftësitë dhe sjellja sipërmarrëse	3 orë
Tema 3	Vetvlerësimi i potencialit personal	3 orë
Tema 4	Vlerësimi i kërkesave, dëshirave, mundësive dhe vështirësive	4 orë
Tema 5	Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja	4 orë
Tema 6	Qëndrimi kritik dhe krijues ndaj zgjidhjeve të bëra, sukseseve dhe dështimeve	3 orë

Tema 7	Etika e komunikimit dhe negocimit	4 orë
Tema 8	Puna individuale dhe puna në grup	4 orë
Tema 9	Gatishmëria, iniciativa dhe motivimi	3 orë
Tema 10	Përgjegjësia individuale dhe shoqërore	3 orë
Tema 11	Menaxhimi eficient i burimeve	3 orë
Tema 12	Aftësitë udhëheqëse në kontekstin e sipërmarrjes	3 orë
Tema 13	Globalizimi, informacioni, mjedisi dixhital dhe mediat sociale	5 orë
Tema 14	Sipërmarrja e biznesit dhe sipërmarrja sociale	3 orë
Tema 15	Format e organizimit të sipërmarrjeve	5 orë
Tema 16	Konteksti i sipërmarrjeve, tregjet, klientela, konkurenca, kostot etj.	6 orë
Tema 17	Mjedisi ligjor i sipërmarrjeve	5 orë
Tema 18	Marrëdhëniet e punës	4 orë

2. Lënda “Njohuri për lëkurën” (L-10-433-16). Kl. 12 – 68 orë

• Synimet e lëndës “Njohuri për lëkurën” kl. 12 - 68 orë.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Njohuri për lëkurën”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të listojnë vetitë e përgjithëshme të lëndëve të para dhe materjaleve ndihmëse të lëkurës për galanteri
- Të argumentojnë rëndësinë e operacioneve mekanike, fizike dhe kimike që kryhen për përpunimin e lëkurave natyrale
- Të listojnë lëkurat e pa përpunuara sipas origjinës
- Të përshkruajnë rëndësinë e proceseve të përpunimit të lëkurës për galanteri
- Të përshkruajnë llojet dhe rëndësinë e klasifikimit të lëkurave tregtare
- Të listojnë vetitë e lëkurëve tregtare sipas funksionit që kryejnë në galanteri
- Të përshkruajnë proceset e përfimit të materialeve prej lëkure (kamosh, pelice, ilustrinë, etj).
- Të dallojnë me anë të shikimit dhe prekjes karakteristikat e lëkurës
- Të interpretojnë mënyrat e përfimit të peliçes nga lloje të ndryshme kafshësh
- Të listojnë vetitë e lëkurëve artificiale dhe sintetike
- Të përshkruajnë ndryshimet ndërmjet lëkurave tregtare dhe atyre artificiale e sintetike.
- Të shpjegojnë përdorimet e masave plastike dhe të gomës në galanteri
- Të tregojnë mënyrat e përfimit të gomës në formë pllake
- Të listojnë lëndët e para kimike për prodhimin e masave plastike
- Të shpjegojnë rëndësinë e përdorimit të ngjitësave në galanteri
- Të përshkruajnë ndarjen e ngjitësave sipas origjinës
- Të listojnë vetitë e ngjitësave bimorë, shtazorë dhe sintetike.
- Të prezantojnë mënyra të ndryshme të përdorimit të materialeve prej tekstili në galanteri

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Njohuri për lëkurën”, kl. 12 - 68 orë**

Tema 1	Njohuri të përgjithëshme mbi teknologjinë e lëkurës për galanteri dhe materjaleve ndihmëse	5 orë
Tema 2	Lëndët e para, gjysmëprodhimet dhe prodhimet e gatëshme të lëkurës për galanteri	5 orë
Tema 3	Lëkura natyrale dhe teknologjia për përpunimin e saj, llojet e lëkurave të papërpunuara	8 orë
Tema 4	Proçeset përgatitore te përpunimit të lëkurës për galanteri	6 orë
Tema 5	Shtresëzimet dhe cilësitë e lëkurës	3 orë
Tema 6	Llojet e lëkurave tregtare dhe përdorimet e tyre në galanteri	7 orë
Tema 7	Lëkura kamosh, përdorimet dhe mënyrat e përfutimit të saj	3 orë
Tema 8	Peliçet. Njohuri të përgjithëshme	4 orë
Tema 9	Lëkurat artificiale dhe sintetike. Llojet dhe përparësitë e tyre ne prodhimet e galanterisë	7 orë
Tema 10	Masat plastike dhe goma për pjesën e poshtme të këpucëve	6 orë
Tema 11	Ngjitësat (bimorë, shtazorë, sintetikë) që përdoren në galanteri	8 orë
Tema 12	Materialet tekstile që përdoren në galanteri	6 orë

3. Lënda “Mjetet dhe makineritë për prerjen dhe qepjen e lëkurës” (L-10-434-16). Kl. 12 – 34 orë

• **Synimet e lëndës “Mjetet dhe makineritë për prerjen dhe qepjen e lëkurës”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Mjetet dhe makineritë për prerjen dhe qepjen e lëkurës”, kl. 12, nxënësit duhet:

- Të listojnë llojet e mjeteve dhe makinerive të ndryshme që përdoren në galanteri
- Të përshkruajnë mënyrat e klasifikimit të këtyre mjeteve dhe makinerive
- Të analizojnë ndikimin e vetive të lëkurëve të ndryshme në klasifikimin emjeteve dhe makinerive
- Të listojnë mjetet dhe makineritë që përdoren për prerjen e lëkurës(thika të ndryshme, presa mekanike, hidraulike, automatike dhe program kompjuterik)
- Të përshkruajnë konstruksionin e mjeteve dhe makinerive prerëse
- Të analizojnë funksionin e mjeteve dhe makinerive prerëse, sipas proçeseve të ndryshme në prerjen e lëkurës.
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave familjare dhe industriale për qepjen e veshjeve prej lëkure
- Të listojnë llojet e gjilpërave sipas ndërtimit të tyre
- Të përshkruajnë funksionin që kanë gjilpërat me rol të dyfishtë (çpim plus qepje)
- Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin që kryejnë këmbëzat e ndryshme (rul, teflon plastike etj.) në proçeset e qepjes së rregullt
- Të përshkruajnë llojet e tegelave që përdoren për qepje sipas vetive të lëkurëve
- Të përshkruajnë llojet e penjëve që përdoren për qepje



- Të analizojnë vetitë e penjëve që përdoren për llojeve të ndryshme lëkurash
 - Të listojnë mënyrat e qepjes së këpucëve të ndryshme prej lëkure (tegel, ngjitje, spërkatje dhe vullkanizim)
 - Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave për qepjen e këpucëve
 - Të analizojnë funksionimin e tyre sipas mënyrave të ndryshme të qepjes
 - Të listojnë llojet e mjeteve dhe makinerive që përdoren për qepjen e aksesorëve të ndryshëm
 - Të përshkruajnë ndërtimin e mjeteve dhe makinerive të ndryshme që përdoren për qepjen e aksesorëve
 - Të listojnë llojet e mjeteve dhe makinerive të ndryshme që përdoren në tapiceri
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Mjetet dhe makineritë për prerjen dhe qepjen e lëkurës”, kl. 12 - 34 orë**

Tema 1	Pajisjet që përdoren për prerjen e lëkurës (sipas llojit të materialit dhe konstruksioni i tyre)	2 orë
Tema 2	Klasifikimi i makinave për qepjen e objekteve prej lëkure (galanteri)	3 orë
Tema 3	Makinat për qepjen e veshjeve prej lëkure (ndërtimi e funksionimi) si funde, pantallona, jelekë, xhaketa, xhupa etj.	5 orë
Tema 4	Makinat për qepjen e këpucëve të ndryshme prej lëkure (ndërtimi e funksionimi) si pupa, papuçe, sandale, këpucë, çizme etj.	5 orë
Tema 5	Makinat për qepjen e aksesorëve të ndryshëm prej lëkure (rripa, kuleta, çanta, doreza, kapele etj.)	4 orë
Tema 6	Llojet e makinave që përdoren në tapiceri	4 orë
Tema 7	Llojet e gjilpërave, tegelave dhe penjve që përdoren për qepjen e objekteve prej lëkure	5 orë
Tema 8	Njohuri mbi mjetet dhe makineritë të prerjes dhe qepjes manuale të lëkurës dhe gezofit.	6 orë

4. Lënda “Teknika të realizimit të veshjeve dhe aksesorëve prej lëkure” (L-10-435-16). Kl. 12 –68 orë

- **Synimet e lëndës “Teknika të realizimit të veshjes dhe aksesorëve prej lëkure”, kl. 12.**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknika të realizimit të veshjes dhe aksesorëve prej lëkure”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë përdorimin e lëkurës në veshje dhe aksesorë gjatë periudhave të ndryshme të historisë së modës.
- Të përshkruajnë llojet e rripave të orës dhe të mesit sipas stilit, gjinisë dhe moshës.
- Të shpjegojnë rëndësinë e elasticitetit të lëkurave dhe materialet ndihmëse që përdoren për rripa;
- Të përshkruajnë llojet e kapeleve sipas stilit, gjinisë dhe moshës;



- Të listojnë materialet e lëkurës, materialet ndihmëse dhe aksesorët që përdoren për realizimin e kapeleve;
- Të listojnë teknikat e prerjes dhe të qepjes që përdoren për realizimin e kapeleve në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të përshkruajnë llojet e dorezave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të listojnë materialet e lëkurës, materialet ndihmëse dhe aksesorët që përdoren për realizimin e dorezave;
- Të përshkruajnë teknikat e prerjes dhe të qepjes që përdoren për realizimin e dorezave në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të listojnë llojet e çantave dhe kuletave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të listojnë materialet e lëkurës, materialet ndihmëse dhe aksesorët që përdoren për realizimin e çantave dhe kuletave;
- Të përshkruajnë teknikat e prerjes dhe të qepjes që përdoren për realizimin e çantave dhe kuletave në lidhje me estetikën dhe formën;
- Të analizojnë rëndësinë e elasticitetit të lëkurës në lidhje me llojin e veshjes.
- Të listojnë materialet e lëkurës, materialet ndihmëse dhe aksesorët që përdoren për realizimin e veshjeve;
- Të përshkruajnë teknikat e prerjes dhe të qepjes që përdoren për realizimin e veshjeve në përshtatje me estetikën dhe formën;
- Të listojnë sistemin ndërkombëtar i masës së këpucëve
- Të përshkruajnë llojet e këpucëve sipas stilit, gjinisë dhe moshës;
- Të listojnë materialet e lëkurës, materialet ndihmëse dhe aksesorët që përdoren për realizimin e këpucëve;
- Të përshkruajnë teknikat e prerjes dhe të qepjes që përdoren për realizimin e këpucëve në përshtatje me estetikën dhe formën;

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknika të realizimit të veshjes dhe aksesorëve prej lëkure”, kl. 12 - 68 orë**

Tema 1	Përdorimi i lëkurës në veshje dhe aksesorë gjatë historisë së modës.	2 orë
Tema 2	Modelet e rripave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;	2 orë
Tema 3	Lëkurat dhe materialet ndihmëse që përdoren për realizimin e rripave	6 orë
Tema 4	Modelet e kapeleve sipas stilit, gjinisë dhe moshës;	2 orë
Tema 5	Llojet e lëkurës, materialet ndihmëse, aksesorët dhe teknikat që përdoren për realizimin e kapeleve në lidhje me estetikën dhe formën;	8 orë
Tema 6	Kategoritë e dorezave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;	2 orë
Tema 7	Materialet e lëkurës, materialet ndihmëse, aksesorët dhe teknikat që përdoren për realizimin e dorezave në lidhje me estetikën dhe formën;	8 orë
Tema 8	Kategoritë e çantave sipas stilit, gjinisë dhe moshës;	2 orë
Tema 9	Materialet e lëkurës, materialet ndihmëse, aksesorët dhe teknikat që përdoren për realizimin e çantave dhe kuletave në lidhje me estetikën dhe formën;	8 orë
Tema 10	Rëndësia e elasticitetit të lëkurës në lidhje me llojin e veshjes.	2 orë

Tema 11	Materialet e lëkurës, materialet ndihmëse, aksesorët dhe teknikat që përdoren për realizimin e veshjeve në lidhje me estetikën dhe formën;	12 orë
Tema 12	Sistemi ndërkombëtar i masës së këpucëve	2 orë
Tema 13	Kategoritë e këpucëve sipas stilit, gjinisë dhe moshës;	2 orë
Tema 14	Materialet e lëkurës, materialet ndihmëse, aksesorët dhe teknikat që përdoren për realizimin e këpucëve në lidhje me estetikën dhe formën;	10 orë

IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

1. Moduli “Konfeksionimi i fundit prej lëkure”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Galanteri

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi	KONFEKSIONIMI I FUNDIT PREJ LEKURE	M-10-1317-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike për të realizuar konfeksionimin e fundit prej materiale lëkure	
Kohëzgjatja e modulit	69 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Tekstil – Konfeksion”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndërton skicën dhe kartmodelin e fundit Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;- të marrë masat në trupin e njeriut- të kontrollojë saktësinë e masave të marra- të përzgjedhë modelin e fundit- të realizojë hartimine skicën teknike- të ndërtojë kartmodelin e pjesëve përbërëse të fundit- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli.	
	<p>RM 2 Nxënësi përzgjedh llojin e lëkurës dhe aksesoret ndihmës Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;- të përzgjedhë lëkurën me vetitë e duhura në lidhje me modelin e fundit	

- të përzgjedhë fijet për qepje sipas llojit të lëkurës
- të përzgjedhë astarin në përshtatje me llojin dhe ngjyrën e lëkurës
- të përzgjedhë aksesorët funksionalë(perçina,togza)dhe dekorativë (tantella,tekstile të llojeve të ndryshme)
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi pret fundin prej lëkure

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të përcaktojë gjatësisë së materialit
- të vendosë në drejtimin e duhur të kartmodelit në lëkurë
- të vendosë shenjat e prerjes(cikatjet dhe tolerancat)
- të presë pjesët përbërëse të modelit me mjetet e duhura
- të presë pjesët e astarit
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen provën e fundin prej lëkure

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të ildisë pjesët përbërëse të fundit;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të fundit
- të kostatojë defektet e ndryshme pas provës;
- të korrigjojë defektet e ndryshme pas provës;
- të presë me saktësi astarin;
- të presë me saktësi qemerin;
- pastrimi i vendit të punës
- zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Nxënësi kryen proceset përfundimtare për qepjen e fundit prej lëkure

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së fundit prej lëkure
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e qepjes së fundit prej lëkure
- të fiksojë materialit ngjitës me lëkurën
- të realizojë tegela të ndryshëm zbukurues dhe aksesoreve
- të qepë astarin sipas modelit;
- të bashkojë astarin me fundin
- të vendosë zinxhirin në fund
- të vendosë qemerin
- të realizoj kthimin e palës(me qepje ose ngjitje)
- të hekurosë në varësi të materialit;
- të llogarisë koston e modelit kampion;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe te organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e fundeve të ndryshme prej lëkure.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e fundeve prej lëkure.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave dhe materialeve për modelimin, prerjen, qepjen e fundeve prej lëkure.
 - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen e fundeve prej lëkure.
-

2. Moduli “Konfeksionimi i xhaketës prej lëkure”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Galanteri

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KONFEKSIONIMI I XHAKETËS PREJ LEKURE	M-10-1318-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike për të realizuar konfeksionimin e xhaketës prej materiali lëkure	
Kohëzgjatja e modulit	85 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Tekstil – Konfeksion”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndërton skicën dhe kartmodelin e xhaketës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;- të marrë masat në trupin e njeriut- të kontrolloj saktësinë e masave të marra- të përzgjedhë modelin e xhaketës- të realizojë hartimin e skicën teknike- të ndërtojë kartmodelin e pjesëve përbërëse të xhaketës- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi përzgjedh llojin e lëkurës dhe aksesoret ndihmës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;- të përzgjedhë lëkurën me vetitë e duhura në lidhje me modelin e xhaketës	

- të përzgjedhë fijet për qepje sipas llojit të lëkurës
- të përzgjedhë astarin në përshtatje me llojin dhe ngjyrën e lëkurës
- të përzgjedhë aksesorët funksionalë (perçina, kopsa, togza) dhe dekorativë (perçina për dekor, pafte metalike, tekstile të llojeve të ndryshme (sipas modelit të përzgjedhur në fillim))
- të bëjë pastrimin e vendit të punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Nxënësi pret xhakëtën prej lëkure

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të përcaktojë gjatësinë e materialit
- të vendosë në drejtimin e duhur kartmodelit në lëkurë
- të vendosë shenjat e prerjes (cikatjet dhe tolerancat)
- të presë pjesët përbërëse të modelit me mjetet e duhura
- të presë pjesët e astarit
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Nxënësi kryen provën e xhakëtës prej lëkure

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të ildisë pjesët përbërëse të xhakëtës;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të xhakëtës
- të kostatojë defektet e ndryshme pas provës;
- të korrigjojë defektet e ndryshme pas provës;
- të bëjë pastrimin e vendit të punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Nxënësi kryen proceset përfundimtare për qepjen e xhaketës prej lëkure

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së xhaketës prej lëkure
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të përzgjedhë makinat qepëse për realizimin e qepjes së xhaketës prej lëkure
- të fiksojë materialit ngjitës me lëkurën
- të qepë pjesët përbërëse të xhaketës prej lëkure
- të përgatisë xhepat dhe ti qepi sipas modelit
- të montojë pjesët e përparme me shpinën
- të montojë mëngët
- të montojë jakën
- të realizojë tegela zbukurimi
- të vendosë aksesorët e zbukurimit
- të qepë astarin sipas modelit.
- të bashkojë astarin me xhaketën
- të vendosë perçinat ose të realizojë vrimat e kopsave (sipas modelit)
- të përdorë hekurosjen në varësi të llojit të lëkurës
- të llogaritë koston e xhaketës prej lëkure.
- të pastrojë vendin e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e xhaketave të ndryshme prej lëkure.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e xhaketave prej lëkure.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave dhe materialeve për modelimin, prerjen, qepjen e xhaketave prej lëkure.
 - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen e xhaketave prej lëkure.

3. Moduli “Konfeksionimi i dorezave prej lëkure”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Galanteri

Niveli: III i KSHK

Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KONFEKSIONIMI I DOREZAVE PREJ LEKURE	M-10-1319-16
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të kryer veprimtari praktike për të realizuar konfeksionimin e dorezave prej materiali lëkure	
Kohëzgjatja e modulit	33 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar kualifikimin në drejtimin mësimor “Tekstil – Konfeksion”, niveli II i KSHK.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi ndërton skicën dhe kartmodelin e dorezave <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;- të marrë masat në trupin e dorës- të kontrolloj saktësinë e masave të marra- të përzgjedhë modelin e dorezave në lidhje me moshën dhe gjininë- të realizojë skicën teknike- të ndërtojë kartmodelin e dorezave- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">- Vëzhgim me listë kontrolli. <p>RM 2 Nxënësi përzgjedh llojin e lëkurës dhe aksesoret ndihmës <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;- të përzgjedhë lëkurën me vetitë e duhura në lidhje me modelin e dorezave	

- të përzgjedhë fijet për qepje sipas llojit të lëkurës
